

VENDIM
Nr.623, datë 1.10.2007

MBI SHQYRTIMIN E DOKUMENTACIONIT PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË
SUBJEKTIT RADIOFONIK VENDOR “RADIO PLANET”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Mesila Doda (Demi)	Kryetare
Frano Kulli	Anëtar
Detar Hysi	Anëtar
Alban Karapici	Anëtar
Artan Zeneli	Anëtar
Gent Ibrahim	Anëtar
Sami Neza	Anëtar

Pasi mori në shqyrtim çështjen me:

Objekt: Për shqyrtimin e kërkesës për rinovim licence të paraqitur nga subjekti radiofonik “Radio Planet”.

Baza ligjore: Neni 7, pika 21 dhe neni 25 i ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullorja “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 të KKRT-së.

VËREN SE:

Në përputhje me ligjin nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar dhe rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë” miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003, subjekti radiofonik vendor privat “Radio Planet”, ka paraqitur dosjen e aplikimit për rinovimin e licencës.

Nga shqyrtimi dhe verifikimi tërësor i dokumentacionit të paraqitur, rezultoi se subjekti “Radio Planet” nuk ka paraqitur:

1. Deklaratën mbi vërtetësinë e të dhënave të paraqitura.
2. Të dhënat teknike të transmetuesit, si dhe bllokskemën principiale të funksionimit të transmetimit.
3. Nuk ka paguar detyrimet financiare, pagesën e licencës në shumën prej 57 300 lekësh për vitet 2005 dhe 2006 dhe taksën vjetore për shërbimet e transmetimeve me një detyrim prej 96 000 lekësh për vitet 2005-2006.
4. Dokumentacioni për vlerësimin e aseteve nuk është i plotë, nuk është i vërtetuar nga ekspert kontabël të autorizuar.
5. Parashikimi i planit ekonomiko-financiar i paraqitur në dosje nuk është i plotë, mungon analiza e treguesve ekonomik e financiar.
6. Ka një mospërputhje midis të dhënave të paraqitura në formë tabelore dhe grafike, mungojnë të dhëna të tjera që kanë të bëjnë me përmbajtjen e programeve, të dhënat për programet nuk janë paraqitur mirë estetikisht.
7. Mungojnë CV-të e bordit drejtues, kontratat me punonjësit e radios dhe formulari i pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore janë paraqitur në formë të fotokopjuar.

Në këto kushte, KKRT-ja vëren se dokumentacioni i aplikimit të subjektit radiofonik vendor “Radio Planet” nuk është në përputhje me kërkesat e pikës 8 të rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 të KKRT-së.

Nga sa më sipër rezulton se nuk mund të rinovohet licenca për radion vendore private “Radio Planet”.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7, pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 të KKRT-së dhe ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Nuk rinovohet licenca për subjektin radiofonik vendor privat “Radio Planet”.
2. Licenca me nr.licence 031/FML bëhet e pavlefshme.
3. Subjekti sipas pikës 1 të vendimit, mund të ankohet në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Mesila Doda (Demi)